



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Njoftim për aplikim

2018-05-10 14:23:00

Sekretariati i CEI-t (Nismës së Evropës Qendrore) kërkon tre profesioniste të rinj të administratës publike ose nga shoqëria civile të marrin pjesë në Programin njëvjeçar të Trajnimit të Avancuar të CEI-t, i cili financohet nga Fondi i Bashkëpunimit të CEI-t. Pjesëmarrësit do të asistojnë në organizimin e aktiviteteve të CEI-t për marrëdhëniet me jashtë, marrëdhëniet me publikun dhe menaxhimin e projekteve.

Duhet të njohin gjuhën italiane dhe një nga gjuhët e vendeve të CEI-t. Gjithashtu diploma duhet të jetë në një nga fushat e sipërpërmendura.

Bursa e pjesëmarrësve në këtë trajnim do të jetë €1,650.00 në muaj.

Ju mund të dërgoni aplikimet tuaja në adresën info@cei.int, jo më vonë se data 8 Qershor 2018.

Për detaje të mëtejshme ndodhet informacioni [bashkëlidhur](#).